

**ALBAVIA sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të pavarur**  
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 23

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë Albavia sh.p.k**

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albavia sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Theksim çështje**

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të pairimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, çoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdohë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

  
Luan Kamberi  
Auditues Ligjor

23 Mars 2020



Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	19,588,950	80,539,270
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	518,365,319	397,506,194
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	542,410,074	569,929,078
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	23,863,242	25,515,452
Inventarë	8	51,541,909	53,481,178
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	90,068,609	230,941,644
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>1,245,838,103</b>	<b>1,357,912,816</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktive afatgjatë materiale	10	573,502,447	540,499,658
Llogari të arkëtueshme afatgjatë	11	72,125,476	51,554,029
<b>Total aktive afatgjatë</b>		<b>645,627,923</b>	<b>592,053,687</b>
<b>Total aktive</b>		<b>1,891,466,026</b>	<b>1,949,966,503</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregëtare	12	597,195,612	553,642,188
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	120,149,221	134,520,734
Detyrime tatimore	14	1,683,457	4,399,649
Të tjera detyrime	15	7,505,556	9,393,048
Paradhënie	16	-	6,724,578
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>726,533,846</b>	<b>708,680,197</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë	17	325,676,212	283,067,711
Paradhënie e të ardhurat e shtyra	18	173,210,415	325,674,474
Llogari të pagueshme afatgjatë	19	282,022,437	215,935,958
<b>Total detyrime afatgjatë</b>		<b>780,909,064</b>	<b>824,678,143</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,507,442,910</b>	<b>1,533,358,340</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar		135,300,000	135,300,000
Rezerva ligjore		15,281,127	13,700,277
Rezerva të tjera		230,946,545	235,965,889
Rezerva statutore		25,006	25,006
Fitimi i ushtrimit		2,470,438	31,616,991
<b>Total kapitali</b>	20	<b>384,023,116</b>	<b>416,608,163</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>1,891,466,026</b>	<b>1,949,966,503</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Konsoliduar e Performancës**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	819,260,785	1,734,847,395
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	22	4,000,087	(14,516,763)
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera</b>		<b>(653,487,719)</b>	<b>(1,543,510,820)</b>
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	23	(638,017,329)	(1,521,444,096)
2) Të tjera shpenzime	24	(15,470,390)	(22,066,724)
<b>Shpenzime te personelit</b>	25	<b>(59,893,046)</b>	<b>(80,718,682)</b>
1) Paga dhe shperblime Shpenzime te sigurimeve		(51,240,573)	(69,379,928)
2) shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(8,652,473)	(11,338,754)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(87,753,229)	(46,251,998)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(675,470)	(74,654)
<b>Shpenzime financiare</b>	27	<b>(18,418,362)</b>	<b>(12,551,996)</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		(18,486,311)	(12,584,844)
2) Shpenzime te tjera financiare		67,949	32,848
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>3,033,046</b>	<b>37,222,482</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(562,608)</b>	<b>(5,605,491)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	(562,608)	(5,605,491)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>2,470,438</b>	<b>31,616,991</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>2,470,438</b>	<b>31,616,991</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albavia sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore dhe ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva të rivlerësimit	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2017</b>	<b>135,300,000</b>	<b>12,677,900</b>	<b>216,533,677</b>	<b>(147,607)</b>	<b>20,947,643</b>	<b>385,311,613</b>
Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim	-	-	-	(320,441)	-	(320,441)
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	31,616,991	31,616,991
Transferim në rezerva	-	1,047,383	19,900,260	-	(20,947,643)	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2018</b>	<b>135,300,000</b>	<b>13,725,283</b>	<b>236,433,937</b>	<b>(468,048)</b>	<b>31,616,991</b>	<b>416,608,163</b>
Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim	-	-	-	(55,485)	-	(55,485)
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	2,470,438	2,470,438
Shpërndarje dividendi	-	-	(35,000,000)	-	-	(35,000,000)
Transferim në rezerva	-	1,580,850	30,036,141	-	(31,616,991)	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	<b>135,300,000</b>	<b>15,306,133</b>	<b>231,470,078</b>	<b>(523,533)</b>	<b>2,470,438</b>	<b>384,023,116</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Albavia sh.p.k më \_\_\_\_\_ dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Shkëlqim Rakipaj  
Administrator

  
Hasan Hafizi  
Administrator



**Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	2,470,438	31,616,991
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	151,336
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	87,753,229	46,251,998
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(79,293)	326,097
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	28,613,677	41,273,177
Rënie/(rritje) në inventarë	1,939,269	(8,472,311)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(68,523,931)	(138,479,759)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>52,173,389</b>	<b>(27,332,471)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(126,991,310)	(69,095,433)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	6,314,585	1,831,427
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(120,676,725)</b>	<b>(67,264,006)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Dividente per tu paguar	(35,000,000)	-
Levizjet e huave	42,608,501	85,559,820
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>7,608,501</b>	<b>85,559,820</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(60,894,835)</b>	<b>(9,036,657)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	80,539,270	89,896,368
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit nga përkthimi	(55,485)	(320,441)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4</b> <b>19,588,950</b>	<b>80,539,270</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. Informacion i përgjithshëm**

Albavia Shpk është një shoqëri e regjistruar më 26 Mars 1998, me vendim gjykate Nr. 19077 datë 20 Mars 1998. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 7638 datë 19 Nëntor 1992 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nga statuti i saj. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 135,300,000 lekë.

Shoqëria ka NIPT J81527001Q. Selia e Shoqërisë është Rr. Sulejman Delvina, pranë Zayed Center, Ap.19, Tiranë.

Ortakët e Shoqërisë më 31.12.2019 janë:

- Z. Hasan Hafizi, qytetar shqiptar që zotëron 52 %
- Z. Shkëlqim Rakipaj, qytetar shqiptar që zotëron 48%

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është ndërtimi i rrugëve, ujësjellësa e kanalizime, ndërtime civile e industriale, prodhimi i materialeve asfaltike etj.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 76 punonjës. (2018: 143)

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### **2.5.3. Gjykime mbi efektet pandemise ne parimin e vijimesise**

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

## **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.2. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

**3.3. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Aktivitetet afatgjata materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre.

Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë atë aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese. Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetës së dobishme të aktivitetit.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar këto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2019	2018	
Toka	0%	0%	
Ndërtime e instalime	5/10%	5/10%	
Makineri e Paisje	10 %	10 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Mjete transporti	10 %	10 %	
Paisje zyre	20%	5%	
Paisje kompiuterike	25%	25%	
Instrumenta dhe vegla pune	20%	5%	

Për amortizimin e fabrikës së asfaltit janë përdorur norma amortizimi të diferencuara dhe konkretisht:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2019	2018	
Impianti Teknologjik	5 %	5 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Pajisje energjitike e elektrike	5 %	5 %	
Pajisje të tjera teknike	5 %	5 %	

Llogaritja e amortizimit për AQT e hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data një e muajit pasardhës.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### **3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

**3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	284,558	62,445,130
Vlera në arkë	19,054,033	17,840,388
Total mjete monetare Albavia Shqipëri	<b>19,338,591</b>	<b>80,285,518</b>
Total mjete monetare Kosova	250,359	253,752
	<b>19,588,950</b>	<b>80,539,270</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë për punime në infrastrukturë rrugore	375,396,616	216,021,211
Klientë për shitje apartamentesh	39,157,068	38,761,935
Klientë për shitje produktesh	2,325,658	2,325,658
Klientë për të tjera	82,556,503	79,759,513
Klientë për garanci punimesh	18,929,474	60,637,877
	<u><b>518,365,319</b></u>	<u><b>397,506,194</b></u>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Albavia & Sintram (Kërkesa për arkëtim)	448,703,277	468,942,368
Albavia & Sintram (Të tjera kërkesa)	8,403,006	-
Emuliv	7,245,507	7,245,507
Karl Gega	72,167,250	93,197,217
RECH PROJECT	5,891,034	543,986
	<u><b>542,410,074</b></u>	<u><b>569,929,078</b></u>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Pjesa e detyrimeve dhe gjobave kompesuar por që janë në proces gjyqësor ( Albavia Shqipëri)	2,908,307	2,908,307
TVSH për t'u rregulluar	1,285	1,285
Tatim në burim për t'u rregulluar (paguar në Kosovë)	217,499	217,499
Të tjera	347	345
Tatim fitimi I mbipaguar	4,585,800	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	16,150,004	22,388,016
	<u><b>23,863,242</b></u>	<u><b>25,515,452</b></u>

**8. Inventari**

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Stoku i materialeve të para	23,903,262	35,063,820
Stoku i materialeve ndihmëse	18,342,224	9,062,245
Inventari i imët	6,383,223	6,441,913
Produkt I gatshëm	2,913,200	2,913,200
	<u><b>51,541,909</b></u>	<u><b>53,481,178</b></u>



**9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime Gener 2 për Qukësin	24,703,046	132,875,561
Parapagime per furnizim vendosje Albit	4,166,667	4,166,667
<b>Parapagime</b>	<b>28,869,713</b>	<b>137,042,228</b>
Leja e ndërtimit për ndërtimin e banesës	6,100,431	6,100,431
Sigurime objekti Inter Albania dhe Ansig	1,000,000	-
Të tjera shpenzime në avance	54,098,465	87,798,985
<b>Shpenzime te shtyra</b>	<b>61,198,896</b>	<b>93,899,416</b>
	<u><b>90,068,609</b></u>	<u><b>230,941,644</b></u>

## 10. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>18,119,542</b>	<b>236,301,473</b>	<b>541,134,071</b>	<b>160,182,228</b>	<b>35,412,136</b>	<b>991,149,450</b>
Shtesa	-	-	19,438,664	44,266,997	5,389,772	69,095,433
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(1,980,694)	(1,961,751)	(477,833)	(4,420,278)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>18,119,542</b>	<b>236,301,473</b>	<b>558,592,041</b>	<b>202,487,474</b>	<b>40,324,075</b>	<b>1,055,824,605</b>
Shtesa	-	-	57,693,069	68,968,711	329,530	126,991,310
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(15,679,747)		(942,800)	(16,622,547)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>18,119,542</b>	<b>236,301,473</b>	<b>600,605,363</b>	<b>271,456,185</b>	<b>39,710,805</b>	<b>1,166,193,368</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	-	<b>84,587,950</b>	<b>284,868,658</b>	<b>79,328,241</b>	<b>22,550,854</b>	<b>471,335,703</b>
Amortizimi i vitit	-	11,815,073	22,340,297	9,369,481	2,727,147	46,251,998
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(852,985)	(1,094,455)	(315,314)	(2,262,754)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	-	<b>96,403,023</b>	<b>306,355,970</b>	<b>87,603,267</b>	<b>24,962,687</b>	<b>515,324,947</b>
Amortizimi i vitit	-	11,815,073	42,465,576	30,535,685	2,936,895	87,753,229
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(9,589,072)		(798,183)	(10,387,255)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	-	<b>108,218,096</b>	<b>339,232,474</b>	<b>118,138,952</b>	<b>27,101,399</b>	<b>592,690,921</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>						
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>18,119,542</b>	<b>139,898,450</b>	<b>252,236,071</b>	<b>114,884,207</b>	<b>15,361,388</b>	<b>540,499,658</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>18,119,542</b>	<b>128,083,377</b>	<b>261,372,889</b>	<b>153,317,233</b>	<b>12,609,406</b>	<b>573,502,447</b>

**11. Llogari të arkëtueshme afatgjata**

Llogari të arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve - Garanci	59,079,083	38,606,108
Gener 2 - Garanci	13,046,393	12,947,921
	<u><b>72,125,476</b></u>	<u><b>51,554,029</b></u>

**12. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për punime të kryera	294,386,464	262,621,910
Furnitorë për materiale	266,068,880	230,715,847
Furnitorë për shërbime	14,080,895	15,839,601
Furnitorë për garanci të ndalura	22,234,639	44,034,341
	<u><b>596,770,878</b></u>	<u><b>553,211,699</b></u>
Furnitorë shërbime Kosovë	424,734	430,489
	<u><b>597,195,612</b></u>	<u><b>553,642,188</b></u>

**13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Emuliv shpk	40,146,122	40,160,972
Karl Gega Konstruksion	74,810,351	78,560,351
Albavia&Sintram shoqëri e thjeshtë	5,192,748	15,799,411
	<u><b>120,149,221</b></u>	<u><b>134,520,734</b></u>

**14. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH për t'u paguar	563,623	2,393,315
Tatim mbi fitimin	-	151,336
Tatim në burim	28,821	28,819
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	926,940	1,571,425
Tatim mbi të ardhurat e personale	163,378	254,059
Të tjera	695	695
	<u><b>1,683,457</b></u>	<u><b>4,399,649</b></u>

**15. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj punonjësve	2,693,505	5,306,521
Të tjera	4,812,051	4,086,527
	<u><b>7,505,556</b></u>	<u><b>9,393,048</b></u>

**16. Paradhënie**

Paradhëniet afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie	-	6,724,578
	<u>-</u>	<u><b>6,724,578</b></u>

**17. Hua**

Huatë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Leasing nga bankat	48,301,340	38,672,791
Overdraft nga Tirana Bank	277,374,872	244,394,920
	<u><b>325,676,212</b></u>	<u><b>283,067,711</b></u>

**18. Të ardhurat e shtyra**

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Albavia&Sintram shoqëri e thjeshtë	173,210,415	325,674,474
	<u><b>173,210,415</b></u>	<u><b>325,674,474</b></u>

**19. Llogari të pagueshme afatgjata**

Llogaritë e pagueshme afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për garanci të ndalura	195,784,099	162,056,792
Detyrime të tjera afatgjata	86,238,338	53,879,166
	<u><b>282,022,437</b></u>	<u><b>215,935,958</b></u>

Furnitorët për garanci të ndaluara lidhen me ndalesat e bëra nënkontraktorëve që janë në kontrata joint venture me Shoqërinë në objektin, "Ndertim rruga Qukes-Qafe Plloce".

Shoqëria ka marrë hua ndaj palëve të treta individë dhe ortakëve me qëllim të financimit të investimeve si edhe për mbulimin e nevojave për kapital punues. Për këto hua nuk janë llogaritur apo paguar interesa.

**20. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Shkëlqim Rakipaj	792	64,944,000	48%	792	64,944,000	48%
Hasan Hafizi	858	70,356,000	52%	858	70,356,000	52%
	<b>1,650</b>	<b>135,300,000</b>	<b>100%</b>	<b>1,650</b>	<b>135,300,000</b>	<b>100%</b>

**21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kryerja e shërbimeve (Ndërtimi)	802,513,421	1,698,672,267
Nga shitja e produktit të gatshëm	735,417	5,301,417
Nga shitja e mallrave	2,107,747	14,006,483
Të tjera shitje e shërbime (Makinëritë)	13,904,200	16,867,228
	<b>819,260,785</b>	<b>1,734,847,395</b>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2019
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Qarkullim i tatueshëm	732,003,701
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2018	87,171,417
Shtohet efekti i kurseve të këmbimit të përfshira në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	3,920,794
Shtohen të ardhurat e marra si dëmshpërblim përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	
zbriten te ardhura nga kontrolli	(324,325)
Zbriten të ardhurat e shtyra për 2019	6,724,577
Zbritet vlera kontabël neto e AMM-ve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(6,235,292)
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>823,260,872</b>
Sipas Kontabilitetit	823,260,872
<b>Diferenca</b>	<b>-</b>

**22. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Fitim /(humbje) nga shitja e AAM-ve	79,293	(326,097)
Fitim /(humbje) nga kursi i këmbimit	3,920,794	(14,190,666)
	<b>4,000,087</b>	<b>(14,516,763)</b>
	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<b>Fitim humbje nga shitja e asetëve</b>		
Të ardhura nga shitja e AMM-ve	6,314,585	1,831,427
Vlera kontrabël e AMM-ve të shitura	(6,235,292)	(2,157,524)
	<b>79,293</b>	<b>(326,097)</b>
	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<b>Diferenca këmbimi</b>		
Humbje nga këmbimet valutore	(101,155,150)	(31,260,073)
Fitime nga këmbimet valutore	105,075,944	17,069,407
	<b>3,920,794</b>	<b>(14,190,666)</b>

**23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<b>Kosto e materialeve të para</b>	<b>245,903,720</b>	<b>526,214,483</b>
<b>Kosto e shërbimeve të kryera</b>	<b>392,113,609</b>	<b>995,229,613</b>
Nënkontraktorët	365,173,740	972,330,126
Transport	-	-
Riparime e mirëmbajtje	5,627,631	5,220,531
Shpenzime udhëtime dieta	1,976,828	5,737,700
Qira për prodhimin, magazinimin	4,741,657	4,100,000
Analiza laborator	7,280,000	7,822,500
Konsulencë inxhinierike	7,313,753	18,756
	<b>638,017,329</b>	<b>1,521,444,096</b>

**24. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Taksa vendore	793,522	502,420
Taksë regjistrimi për mjetet	2,132,094	1,805,443
Shpenzime telefoni, poste dhe internet	1,681,871	1,627,345
Shërbime bankare	241,218	1,386,511
Sigurime e Prime	3,856,112	5,316,780
Analiza, konsulencë dhe studime projektive	912,270	1,172,212
Shërbime të ndryshme nga të tretë	1,975,716	3,646,017
Pagesa administrative	43,365	57,308
Blerje energji, avull, ujë	2,040,867	3,738,446
Blerje kancelari	358,959	711,029
Shpenzime qeraje	1,142,480	1,172,445
Shpenzime për pritje e përfaqësime	-	6,833
Shpenzime të tjera	291,916	65,970
Transferime, udhëtime, dieta për administratën	-	857,965
	<u>15,470,390</u>	<u>22,066,724</u>
Shpenzime të tjera Kosova	-	-
	<u><b>15,470,390</b></u>	<u><b>22,066,724</b></u>

**25. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Pagat e personelit	51,240,573	69,379,928
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8,652,473	11,338,754
	<u><b>59,893,046</b></u>	<u><b>80,718,682</b></u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 76 (2018: 143).

**26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	675,470	74,654
	<u><b>675,470</b></u>	<u><b>74,654</b></u>

**27. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të Shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për interesa	18,486,373	12,606,209
Të ardhura nga interesat	(62)	(21,365)
Shpenzime financiare	-	-
Të ardhura financiare	(67,949)	(32,848)
	<u><b>18,418,362</b></u>	<u><b>12,551,996</b></u>

**28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b><i>Fitimi para tatimit</i></b>	<b>3,033,046</b>	<b>37,222,482</b>
Total shpenzime të panjohura		
Shpenzime Pritje e Përcjellje	-	6,833
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	675,470	74,654
Shpenzime të tjera	42,205	65,970
<b><i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i></b>	<b>3,750,721</b>	<b>37,369,939</b>
<b><i>Tatim fitimi @15%</i></b>	<b>562,608</b>	<b>5,605,491</b>



**29. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Albavia & Sintram	448,703,277	5,192,748	468,942,368	15,799,411
Emuliv	7,245,507	40,146,122	7,245,507	40,160,972
Karl Gega	72,167,250	74,810,351	93,197,217	78,560,351
RECH PROJECT	5,891,034	-	543,986	-
Tamara Hydroenergy	8,403,006	-	-	-
Ortakët	-	86,238,338	-	53,879,166
	<b>542,410,074</b>	<b>206,387,559</b>	<b>569,929,078</b>	<b>188,399,900</b>

  

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Karl Gega	-	-	-	5,702,004
RECH PROJECT	13,256,567	63,938,643	54,403,366	70,416,311
Emuliv	-	-	-	-
Albavia & Sintram	422,251,230	-	999,048,740	-
	<b>435,507,797</b>	<b>63,938,643</b>	<b>1,053,452,106</b>	<b>76,118,315</b>

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 4,091,146 Lek.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Administratori Shkelqim Rakipaj	2,045,573	2,875,410
Administratori Hasan Hafizi	2,045,573	2,875,410
	<b>4,091,146</b>	<b>5,750,820</b>

**30. Pasivet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**31. Ngjarje pas bilancit**

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i llogarive të arketueshme, inventari, dhe shtyrja e afatit të kontratave të ndertimit, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpallur në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpallur në shënimin 2.5.3 të këtyre pasqyrave financiare.